

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **POLICIA E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-23-2841-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me uniforma për detyra taktike**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Sodex Group SH.P.K.
NUI	810814063
Adresa	FEHMI AGANI NR.36
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	044148184
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Sodex Group
Adresa elektronike	office@sodex-ks.com
Data e parashtrimit të ankesës	21.09.2023

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me uniforma për detyra taktike

Njoftimi për Kontratë: 29.03.2023

Data e hapjes së tenderit: 23.06.2023

Njoftim mbi vendimin e AK-së: 29.08.2023

Kërkesa për rishqyrtim dt. 01.09.2023

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt.12.09.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 62 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 70 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi për kontratë është bërë me dt. 29.03.2023, ndërsa në këtë aktivitet të prokurimit kanë marr pjesë dy operatorë ekonomik.

Njoftimi mbi vendimin është nxjerr me dt. 29.08.2023, ku është anuluar në tërësi aktiviteti i prokurimit, kurse neve jemi eliminuar me arsyetimin si në vijim.

Tek **artikulli Nr.1 Xhaketë taktike**-Xhaketa e jashtme është kërkuar 10k/10k e papërshkueshëm nga era dhe uji-mungon në 10k/10k në testime;

Artikulli Nr.3 pantallona taktik dimëror është kërkuar testi i qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj zbardhjes së klorit ndërsa ka ofruar test pa klor;

Artikulli Nr.4 KËMISHË TAKTIKE ME MËNGË TË GJATA VERORE është kërkuar testi i qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj zbardhjes së klorit ndërsa ka ofruar test pa klor;

Artikull Nr.5 KËMISHË TAKTIKE ME MËNGË TË GJATA DIMËRORE është kërkuar test i qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj zbardhjes së klorit ndërsa ka ofruar test pa klor;

Artikulli Nr.6 KËMISHË TAKTIKE ME MËNGË TË SHKURTA Pollo është kërkuar testi i qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj zbardhjes së klorit ndërsa ka ofruar test pa klor; mungon testi i elasticitetit;

Artikulli nr.7 KAPELË TAKTIKE është kërkuar testi i qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj zbardhjes se klorit ndërsa ka ofruar test pa klor.

Arsyet e eliminimit janë të paqëndrueshme, ndërsa më poshtë po i elaborojmë pretendimet tona në lidhje me këto arsye të eliminimit.

Pretendimi 1:

Sa i përket artikullit Nr.1 Xhaketë taktike, ku është cekur se Xhaketa e jashtme është kërkuar 10k/10k e papërshkueshëm nga era dhe uji-mungon në 10k/10k në testime, ju sqarojmë se kjo arsye e eliminimit është e paqëndrueshme dhe kjo vërtetohet nga tiketa që është e bashkangjitur në mostra, si më



poshtë:

Pra mostra dhe produkti i ofruar nga ne, i përmban të gjitha specifikimet teknike siç janë kërkuar dhe nuk ka asnjë dilemë në lidhje me këto karakteristika dhe specifika. Është e papërshekueshme nga era dhe uji në 10k/10k, ashtu siç është kërkuar ne DT.

Ne atestim për jakne në faqen 3 shihet qe ajo tejkalon kërkesën e AK-se: “10k/10k e papërshekueshëm nga era dhe uji”, ku dëshmohet se kërkesa e AK-se jo vetëm qe plotësohet por edhe tejkalohet.

Requirements - EN 343:2019

Classification of resistance to water penetration

Water penetration resistance W_p	Class			
	1	2	3	4
Specimen to be tested				
• Material before pretreatment	$W_p \geq 8\,000\text{ Pa}$	No test required	No test required	No test required
• Material after each pre-treatment	No test required ^a	$W_p \geq 8\,000\text{ Pa}$	$W_p \geq 13\,000\text{ Pa}$	$W_p \geq 20\,000\text{ Pa}$
• Seam before pretreatment	$W_p \geq 8\,000\text{ Pa}$	$W_p \geq 8\,000\text{ Pa}$	$W_p \geq 13\,000\text{ Pa}$	No test required
• seams after pre-treatment by cleaning	No test required	No test required	No test required	$W_p \geq 20\,000\text{ Pa}$

Sqarim:

Wp është water penetration resistance (rezistencë ndaj depërtimit të ujit)

10k është 10 000 Pa, ndërsa Xhaketa e ofruar e ka kaluar testin madje 20 000 Pa (20k)

Pretendimi 2:

Sa i përket artikujve Nr, 3, 4, 5, 6, 7 e ku autoriteti kontraktues e ka shënuar se është kërkuar testi i qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj zbardhjes së klorit ndërsa janë ofruar teste pa klor, ju sqarojmë se për të gjitha këto produkte, në mostrat përkatëse shihen qartë informatat për larjen e rrobave, e ku shihet që këto materiale dhe produkte janë rezistence ndaj zbardhjes.

Në secilën mostër është bashkangjitur etiketa standarde e prodhuesit, ku dëshmohet qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj zbardhjes.

Po ashtu për secilin artikull kemi dorëzuar atestet për qëndrueshmërinë e ngjyrës ndaj zbardhjes dhe të njëjtat i kanë tejkaluar standardet e kërkuara siç edhe shihet nga atestet e dorëzuara në të cilat shkruan: [Color fastness to Non-Chlorine Bleach as received \(AATCC TS-001, Soaking in 1.88% Clorox Solution at 120F for one minute\).](#)

Në secilin atest të ofruar të qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj zbardhjes është përdorur substance **Clorox 2** e cila është, citoj: ...Një solucion 1.88% Clorox 2 do të thotë që tretësira përmban 1.88% peroksid hidrogjeni (H₂O₂) si përbërësin e saj aktiv. Clorox 2 është një produkt lavanderie që përdor peroksid hidrogjeni si një zbardhues ekuivalent i sigurt për ngjyrat ndaj zbardhuesit të klorit. Është projektuar për të ndihmuar në heqjen e njollave dhe ndriçimin e ngjyrave në veshje pa ashpërsinë e zbardhuesit të klorit.



what is 1.88% clorox 2 solution



A 1.88% Clorox 2 solution typically means that the solution contains 1.88% peroxide (H_2O_2) as its active ingredient. Clorox 2 is a laundry product that uses peroxide as a color-safe bleach alternative to chlorine bleach. It is designed to remove stains and brighten colors in clothing without the harshness of chlorine bleach.

As with any cleaning or laundry product, it's essential to follow the manufacturer's instructions for proper usage and dilution. Be sure to test a small, inconspicuous area of clothing before using Clorox 2 on a larger scale to ensure it won't cause any fading to your fabrics.



What is 1.88% Clorox 2 solution?! Source: ChatGPT (<https://chat.openai.com/>)

A 1.88% Clorox 2 solution typically means that the solution contains 1.88% hydrogen peroxide (H₂O₂) as its active ingredient. Clorox 2 is a laundry product that uses hydrogen peroxide as a color-safe bleach alternative to chlorine bleach. It is designed to help remove stains and brighten colors in clothing without the harshness of chlorine bleach.

Për më tepër, një kërkim i thjeshtë në internet sa i përket këtij pretendimi ankimor (është kërkuar testi i qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj zbardhjes së klorit ndërsa ka ofruar test pa klor) mund te konstatohet se ajo që kemi ofruar ne është profesionale për PK-në (Testi i qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj zbardhjes / Color fastness test to bleaching) dhe jo këto që AK-ja pretendon se nuk janë ofruar si duhet (Zbardhja me klor / Chlorine bleaching), citojmë:

1. The "**Color fastness test to bleaching**" is a textile testing procedure specifically designed to evaluate how well a fabric resists fading when exposed to bleach during laundering. It is a controlled laboratory test that assesses the fabric's performance.

2. "**Chlorine bleaching**" refers to the actual use of chlorine bleach in the laundry process. It is a practical application of a bleaching agent to whiten or disinfect fabrics, products like bed linens.

në përkthim i bie:

1. "**Testi i qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj zbardhjes**" është një procedurë testimi tekstili i krijuar posaçërisht për të vlerësuar se sa mirë një pëlhurë i reziston zbehjes kur ekspozohet ndaj zbardhjes gjatë larjes. Është një test laboratorik i kontrolluar që vlerëson performancën e pëlhurës.

2. "**Zbardhja me klor**" i referohet përdorimit aktual të zbardhjes së klorit në procesin e larjes së rrobave. Është një aplikim praktik i një agjenti zbardhës për të zbardhur ose dezinfektuar pëlhurat, produkte si çarçafët e krevatit.

Rrjedhimisht i bie që testi i ofruar nga ne është testi që përmban edhe testimin **ekuivalent** me atë të kërkuar në DT dhe si i tillë është atesti i vetëm i duhur me standardet ndërkombëtare (Standardi Amerikan në rastin tonë, AATCC TS-001) për uniformat e kërkues nga PK, dhe jo "testi i zbardhjes me klor", i cili përdoret për zbardhimin e tekstilit (çarshafet, postavat, peshqirat etj).

Pretendimi 3:

Sa i përket arsyes së eliminimit ku është cekur se mungon testi i elasticitetit për artikullin Nr.6- KËMISHË TAKTIKE ME MËNGË TË SHKURTA, ju konfirmojmë se ky test gjendet në faqen 94 (pika 11) të atesteve të dorëzuara me ofertë, prandaj kërkojmë nga OSHP-ja që të analizohen në detaje atestet dhe dëshmitë e ofruara nga ne.

REDACTED

7 Colour Fastness To Water (AATCC 107-2013):		
Colour Change	4.5	Requirement
Colour Staining		4.0
-Acetate	4.5	3.0
-Cotton	4.5	
-Nylon	4.5	
-Polyester	4.5	
-Acrylic	4.5	
-Wool	4.5	
8 Colour Fastness To Light (AATCC 16.3-2014, Option 3, Xenon-Arc Lamp):		
20 AATCC Fading Unit (AFU) Exposure	4.0	
Shade Change		
9 Colour Fastness To Perspiration And Light (AATCC 125-2013):		
20 AATCC Fading Unit (AFU) Exposure	4.0	
Grade		
10 Colour Fastness To Non-Chlorine Bleach As Received (AATCC TS-001, Soaking In 1.89% Clorox 2 Solution At 120°F For One Minute):		
Colour Change	4.5	
11 Tensile Strength As Received (ASTM D5034-09(R17), 1-Inch Grab Test, Tensile Testing Machine, CRE):		
Warp	165.3 lbs	
Weft	124.6 lbs	
12 Tearing Strength As Received (ASTM D1424-09(R13)e1, Elmendorf Tear Tester):		
Warp	6.1 lbs	
Weft	6.5 lbs	
13 Seam Strength As Received (ASTM D1683/D1683H-2017e1, Tensile Testing Machine, CRE):		
S.O. 1/8"		
// To Warp	Less than 1/8 inch slippage	
// To Weft	Less than 1/8 inch slippage	
Strength		
// To Warp	85.5 lbs (STR/FTS)	
// To Weft	95.0 lbs (STB)	
Remark : S.O. 1/8" = Seam opened at 1/8 inch		
FTS = Fabric torn at seam		
STB = Sewing thread broken		

Google Translate

Text Images Documents Websites

Detect language English Albanian German

Albanian English German

tensile

tensile

elastik

tensile strength

qëndrueshmëria në tërheqje

tensile stress

stresi në tërheqje

elastik

Adjective resilient elastic flexible tensile springy pliable [Look up details](#)

🔊

📄

🔍

🔗

More translations

Expand all

i zgjatshëm

Adjective

extendible

tractile

extensile

tensile

protraci

Ju sqarojmë se Color change nuk ka të bëjë me pikën 11 siç ka pretenduar autoriteti kontraktues por ka të bëjë me rezultatin e pikës Nr.10.

Nëse Autoriteti kontraktues ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me mostrat, specifikat, atestet apo çfarëdo dokumenti tjetër ka mundur që konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së të kërkojë sqarime shtese, edhe pse dëshmitë e ofruara nga ne janë të qarta.

Po ashtu po ua **bashkëngjisim edhe deklaratën nga prodhuesi** që konfirmon dhe dëshmon se mostrat e dorëzuara janë testuar për qëndrueshmërinë e ngjyrës ndaj zbardhjes, madje të njëjtat i tejkalojnë standardet e kërkuara për atestim.



5.11 International
Geijersgatan 2b
SE-216 18 Limhamn
SWEDEN
Tel: +46 (0)40 467 388
Fax: +46 (0)40 467 399

5.11 Middle East & Africa
1804 DAMAC Executive Heights
TECOM
DUBAI
Tel: +971 (0)4 456 6383

Limhamn, September 1st, 2023

Attn:
POLICIA E KOSOVËS
LUAN HARADINAJ, P.N.
10000 PRISHTINE
REPUBLIC OF KOSOVO

CLARIFICATION STATEMENT

Reference: 214-23-2841-1-1-1
Title: Furnizim me uniforma për detyra taktike (Supply of uniforms for tactical tasks)

Upon careful examination of the test reports submitted for the items in consideration for the Kosovo Police tender titled Supply of uniforms for tactical tasks, we wish to address the raised points resulting in the elimination of our offer.

1. Waterproofness and Breathability: We contest the elimination in this category, as our jacket has undergone testing and has successfully passed the specified requirements. Notably, our jacket not only meets but exceeds the CA requirement of "10k/10k windproof and waterproof." Please review the attached evidence on page 3, which clearly demonstrates that our product surpasses the CA's stipulated standards.

2. Missing Test for "Color Fastness Test to Bleaching", items: Stryke Pant, Stryke TDU Long Sleeve Shirt, Stryke Shirt Long Sleeve, Performance Polo Shirt Short Sleeve and Fast-Tac Uniform Cap: We affirm that the samples were duly submitted, and we have provided the necessary test reports for the "Color fastness test to bleaching." We are pleased to announce that all samples have successfully passed this test. We kindly request a thorough review of the documentation, which unequivocally substantiates the completion and success of the "Color fastness test to bleaching."

3. Elasticity Test for Tactical Shirts: Article 6 of the tactical shirts category mentions a missing elasticity test. However, we would like to draw your attention to page number 96, where it explicitly states that this test was conducted and successfully passed.

Furthermore, we emphasize that police and duty uniforms worldwide should be laundered with bleach, excluding chlorine bleach, as per your mention. Chlorine bleach is discouraged for use on any professional uniforms, especially those intended for Law Enforcement and Police use.

We kindly request a thorough reevaluation of our submission in light of these clarifications.

Very truly yours,

Jörgen Andersson
Managing Director 5.11 International



www.511Tactical.com

ALWAYS BE READY.

Duke pasur parasysh sqarimet që i cekëm më lartë dhe dëshmitë që janë prezantuar me rastin e ofertimit, rezulton se ne i plotësojmë të gjitha kërkesat dhe specifikat e dosjes së tenderit dhe jemi operator ekonomik i përgjegjshëm, prandaj arsyeja e eliminimit është e pa bazuar.

Mbi këtë bazë kërkojmë nga OSHP që të analizojë në detaje të gjitha dëshmitë e ofruara nga ne dhe të nxjerr një vendim meritore në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimet tjera në lidhje me OE tjetër ofertues:

Ne pajtohemi me arsyet e eliminimit që i ka dhënë AK-ja për grupin e GOE “RUNWAY SHPK&GENC TAAHHUT GIYIM TEKSTIL INSAAT SAN. VE. TIC. LTD. STI VKN”.

Pretendimi 4:

Përveç asaj që AK ka konstatuar mangësi tek GOE “RUNWAY SHPK&GENC TAAHHUT GIYIM TEKSTIL INSAAT SAN. VE. TIC. LTD. STI VKN”, ju sqarojmë se ky ofertues nuk është i përgjegjshëm edhe për faktet e radhaturat me poshtë:

Është kërkuar që: *Khaketa e jashtme është e qepur dhe e ngjitur me tegel plotësisht të vullkanizuar për rezistencë ndaj ujit* ndërsa OE në fjalë ka ofruar Xhaketën e jashtme e cila është bërë me shirita të pa vullkanizuar.



Ne me dt. 12.09.2023 kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar.

Në lidhje me përgjigjen në pretendimin Nr.1, autoriteti kontraktues e ka cekur se OE ka ofruar një etiketë e cila është prezantuar edhe me kërkesë për rishqyrtim por kjo nuk është atest nga laborator i licencuar dhe akredituar që dëshmon materialin e jakës xhaketës sipas specifikimeve teknike.

Ky konstatim i AK-së është i paqëndrueshëm, sepse Xhaketa e ofruar nga ne e ka kaluar testin, madje 20 000 Pa (20k), e që i bie se e ka tejkaluar kërkesën në lidhje me

rezistencën ndaj depërtimit të ujit.

Kjo është dëshmuar më lartë në ankesë tek pretendimi i parë ankimor.

Në përgjigjen në pretendimin **Nr. 2**, autoriteti kontraktues e ka cilësuar si të bazuar pretendimin tonë ankimor përkitazi me testin e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj zbardhjes, prandaj nuk kem arsye të bëjmë ndonjë koment apo elaborim të mëtutjeshëm.

Në përgjigjen në pretendimin **Nr.3**, autoriteti kontraktues e ka cekur se pretendimi jonë është i pabazuar sepse kemi ofruar një atest të elasticitetit të ngjyrës në tërheqje e cila ka edhe parametrat e prezantuar në atest.

Po ashtu e ka vendosur edhe foton si më poshtë:



Ju sqarojmë se Color change nuk ka të bëjë me pikën 11 siç ka pretenduar autoriteti kontraktues por ka të bëjë me rezultatin e pikës Nr.10.

Nga kjo dëshmi kuptohet se AK-së ka bërë një ngatërresë e cila ka mundur të ndodh edhe nga mos njohuritë në lidhje me këto produkte-specifika.

Pra Color change është rezultat për pikën Nr.10 e jo për 11 siç është përgjigjur dhe siç ka pretenduar autoriteti kontraktues.

Kjo duhet të jetë si më poshtë dhe se **pika 11** e percakton elasticitetin (sipas kërkeses se

AK-se ne dosje te tenderit):

10	Colour Fastness To Non-Chlorine Bleach As Received (AATCC TS-001, 120°F For One Minute):	
	Colour Change	4.5
11	Tensile Strength As Received (ASTM D5034-09(R17), 1-Inch Grab Test	
	Warp	165.3 lbs
	Weft	124.6 lbs

Në lidhje me pretendimin tonë ankimor përkitazi me ofertën e grupit të “RUNWAY SHPK&GENC TAAHHUT GIYIM TEKSTIL INSAAT SAN. VE. TIC. LTD. STI VKN” nuk kemi pranuar përgjigje, prandaj me këtë rast nuk është respektuar neni 108/A paragrafi 9 i LPP-së.

Pra vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim nuk është i bazuar dhe nuk janë dhënë arsyetime konkrete në lidhje me pretendimet tona ankimore, me përjashtim të përgjigjes në pretendimin Nr.2.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, **e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse na ka diskriminuar neve duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-*

diskriminuuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

Autoriteti kontraktues është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **Sodex Group SH.P.K.**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit, si dhe lënda të kthehet në

RIVLERSIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim, ankesave etj. në vlerë prej 10,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.